



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:282960  
Datë: 04.09.2024  
Numri i dokumentit: 06122133

K.DH.SH.II.nr.1069/24

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**- Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ramush Bardiqi, kryetar, Krenar Berisha dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Kolegji Ilria” me seli në Prishtinë, kundër të paditurit Agjencia e Kosovës për Akreditim Këshilli Shtetëror i Cilësisë, me seli në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.280/22, të datës 22.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 28.08.2024, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e të paditurës Agjencia e Kosovës për Akreditim Këshilli Shtetëror i Cilësisë, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.280/22, të datës 22.02.2024, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar KA.nr.280/22, të datës 22.02.2024, ka vendosur si në vijim: I. Aprovohet pjesërisht e bazuar kërkesëpadija e paditësi “Kolegji Iliria”, me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Agjencia e Kosovës për Akreditim, me seli në Prishtinë. II. Anulohet vendimi/njoftimi i datës 16.09.2019, dhe Vendimi i Këshillit Shtetërorë të Cilësisë nr. 1365/19D i datës 29 Korrik 2019, çështja i kthehet të paditurës në rivendosje tek organi i administratës, III. Obligohet e paditura që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, në ri procedurë të veprojnë sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim. IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur e paditura, për shkak të: aplikimit të gabuar të dispozitave materiale dhe konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozimin që të aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurit, të prishet aktgjykimi i kontestuar dhe çështja të kthehet në rivendosje ose të aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa e të paditurit të ndryshohet aktgjykimi i kontestuar, ashtu që të mbetet në fuqi vendim i KShC Ref.:1365/19D datë

29.07.2019, ndërsa ankesa e Kolegjit Iliria i kthehet për rishqyrtim Komisionit të ankesave në Agjencinë e Kosovës për Akreditim.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur paditësi, duke kontestuar në tërësi ankesën e të paditurit, me propozimin që të refuzohet në tërësi ankesa e të paditurës si e pabazuar dhe të vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Komerciale – Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.280/22 datë 22.02.2024.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe vlerësimit komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të zbatueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është **e pa-bazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështjet Administrative, me datën 03.10.2019, ka paraqitur padi kundër vendimit të datës 16.09.2019 për refuzimin e ankesës së Kolegjit Iliria, nga Agjencia e Kosovës për Akreditim dhe vendimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC) nr.1365/19D të datës 29.07.2019, për shkak se nuk janë aplikuar drejtë dispozitat ligjore.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, me aktgjykimin KA.nr. 280/22 të datës 22.02.2024 e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar (si në dispozitiv të këtij aktgjykimit).

Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë ndër tjerash ka konstatuar se: Gjykata vlerëson se me Njoftim (që paditësi i referohet vendim) i dërguar përmes emal-it, nga AKA me datë 17.09.2019. paditësi është njoftuar se në mbledhjen e saj të 77-të, i datës 16.09.2019, Këshilli Shtetëror i Cilësisë ka trajtuar ankesat e drejtuara nga Institucionet e Arsimit të Lartë. Pas shqyrtimit të këtyre ankesave, KSHC, ka vendosur që të qëndroj prapa vendimeve të saj fillestare, duke u bazuar në raportet e ekspertëve dhe gjendjen e njëjtë nga vendimi paraprak. Gjithashtu AKA e njofton se, Komisioni i Ankesave të AKA-së, ka dhënë dorëheqje Si rezultat i kësaj AKA fton IAL-të, që të drejtën për ankim ta shfrytëzojnë sipas legjislacionit në fuqi. Gjykata vlerëson se përmes këtij njoftimi ngritën disa çështje, si: se për çfarë shqyrtimi të ankesës bëhet fjalë, se në çfarë cilësie Këshilli Shtetëror i Cilësisë e ka trajtuar ankesën, si organ i shkallës së parë apo si organ i shkallës së dytë, çfarë vendimit është marrë, me çfarë baze ligjore, dhe në mungesë të Komisionit funksional të Ankesave të AKA- së, a është ka kompetencë ligjore Këshilli Shtetëror i Cilësisë të ti trajtoj ankesat dhe të vendos nëse qëndron pran apo jo të vendimit të shkallës së parë të organit administrativ. 41) Neni 22 i UA 15/2018 parasheh të drejtën ankimore, ndërsa paragrafi 1 I këtij neni parasheh se Komisioni i Ankesave do te trajtoj dhe do të vendos për ankesat e parashtruara nga institucionet e arsimit të lartë kundër vendimeve të KSHC-së. 2. Ankesa parashtrohet Brenda afatit prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KSHC-së në përputhje me Ligjin mbi Procedurën Administrative, 3. Komisioni

i Ankesave shqyrton ankesën dhe nxjerr vendim brenda 30 ditësh nga data e dorëzimit të ankesës. 42) Paditësi Kolegji Iliria ndaj vendimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë nr. 1365/19D të datës 29 Korrik 2019 kishte parashtruar ankesë me datë 22.08.2019, por e paditura në shqyrtimin e ankesës ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e UA-së si në paragrafin e mësipërm. Prandaj gjykata i vlerëson të bazuara pretendimet e paditësit në raport me njoftimin e datës 17.09.2019, me arsyetim se vendimi i datës 16.09.2019 është i kundërligjshme dhe si të tillë duhet të anulohen për faktin se të njëjtit i mungon forma e aktit administrativ, si element kyç ligjor për të qenë një akt përfundimtar i organit administrativ, dhe në kundërshtim me nenin 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA), dhe se mungesa e formës së aktit administrativ, është i barabartë me vet mungesën e aktit administrative. 43) Në kuptim të nenit 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative përcaktohet se: “Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative.” dhe në kuptim të nenit 13 par. 2 i cili përcakton: “Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar. Mirëpo gjykata vlerëson se ankimimi kundër Vendimi i Këshillit Shtetërorë të Cilësisë nr. 1365/19D i datës 29 Korrik 2019, është i lejuar prandaj duhet ti nënshtrohet vlerësimit të dyshkallshmërisë brenda organit administrative, në pajtim me dispozitat ligjore.

Në këtë drejtim Gjykata e shkallës së parë për vërtetimin e saktë të gjendjes faktike kishte administruar një mori provash materiale si në arsyetim të aktgjykimit. Për mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë - Departamenti për Çështjet Administrative, është bazuar të nenit 5,6, 38, 43 dhe 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Gjykata Komerciale e Kosovës- Dhomat e Shkalës së Dytë e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktgjykimi i atakuar me ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 dhe 2 pika n), ku përcakton se:

Sa i përket pretendimeve të të paditurit se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar gabimisht gjendjen faktike, Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë, nuk i aprovoi këto pretendime si të bazuara. Aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm dhe ka ofruar arsyetim të mjaftueshëm për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Në ankesën e paraqitur, e paditura nuk ka arritur të paraqesë argumente të kundërta ndaj atyre që i ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë, e cila ka ofruar shpjegime konkrete për secilin program të studimit që nuk është riakredituar. Këto shpjegime janë në përputhje me dispozitat ligjore, ndërsa me të drejtë është konstatuar se vendimi i kontestuar/ njoftimi i datës 17.09.2019, është marrë vendimi me datës 16.09.2019, pa u shqyrtuar ankesat nga organi kompetent, e që ky njoftim/vendim përmban të meta të tilla për shkak të të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative (LPA). Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 47 dhe 48 këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimin e goditur me padi, duhet të përmbajë përveç tjerash edhe një përmbledhje të

konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti, etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të pretendimeve në padi, përgjigjes në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se padia e paditësit është e bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore për shkelje esenciale të dispozitave procedurale, ky pretendim nuk qëndron, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë që gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankiomore në ankesë për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, pasi që arsyetimin e aktgjykimit e bazon thjeshtë në provat dhe të dhënat të cilat i arsyeton përfaqësuesi i paditësit. kolegji i kësaj gjykate këto pretendime nuk i aprovoi, meqë gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerr prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se vendimi i kontestuar përmban të meta të tilla që pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së tij, dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur që në ri procedurë t'i mënjanoj të metat e cekura. Kjo për faktin sepse akti i tillë individual përfundimtar nuk është i plotë dhe përmbajtësor për tu vlerësuar ligjshmëria e tij si në vështrim të nenit 9 dhe 44 të LKA-së, ngase përmban të meta esenciale, që pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë dhe nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike. andaj duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, gjykata gjen se akti administrativ duhet të jetë në kuptim të nenit 47 dhe 48 të Ligjit për procedurën Administrative. Prandaj, në një gjendje të tillë të vlerësimit, sipas bindjes së kësaj gjykate e bën të pa qëndrueshëm arsyetimin e vendimit kontestues, ngase në arsyetim të vendimit të kontestuar është dashur të vlerësohen pretendimet e paditësit që kanë rëndësi vendimtare në mënyrë që të jepen sqarime bindëse.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje të konstatuar, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nga gjykata e shkallës së parë dhe se nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës, nga shkak se e paditura me asnjë provë nuk e ka vërtetuar një gjendje të tillë të krijuar për mos mundësinë e vendosjes ashtu siç me dispozitat e neneve të lartcekura të LPA-së. Ngase akti administrativ, mund të kontestohet në konfliktin administrativ për shkaqe të paligjshmërisë formale dhe materiale. Shkaqet e paligjshmërisë formale juridike janë shkelja e rregullave të procedurës që konsistojnë edhe në të metat në formën e aktit dhe në mungesën e arsyetimit etj. Ndërsa nga vendimi i kontestuar nuk mund të kuptohet

se si është vërtetuar gjendja faktike, ngase nuk janë ofruar prova të mjaftueshme dhe bindëse, ndërsa provat e prezantuara nuk janë me ndikim në vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative.

Kurse, sa i përket pretendimeve tjera ankimore se gjykata e shkallës së parë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale, ky kolegji nuk i aprovoi sepse vlerësoi se janë të pabazuara dhe pa ndikim në vërtetimin e gjendjes faktike nga ajo e vetëtuar edhe nga gjykata e shkallës së parë, për shkak se vendimi i kontestuar i të paditurës përmban të meta të tilla esenciale të lartcekura që pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së tij. Andaj, aktgjykimi i ankimuar është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Duke marr parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadsisë së paditësit, me të cilin ka anuluar vendimin e të paditurës, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura të njëpasnjëshme një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzuar si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës së Shkallës së Parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadsisë së paditëses, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Kolegji vlerëson gjykata e shkallës së parë përfundimin e tërë kësaj procedure e ka arsyetuar në masë të mjaftueshme sa i përket rrethanave që kanë ndikuar në aprovimin e kërkesë-padsisë. Gjykata e Komerciale e Kosovës vlerëson se mbi bazën e gjendjes faktike të konstatuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar edhe të drejtën materiale. Përfundimisht, Gjykata e Komerciale e Kosovës i ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, por nuk ka gjetur se ekziston ndonjë shkelje e cila do të ndikonte që vendimi të kualifikohet si i tillë për çka çështja pastaj do të duhej të kthehej në rishqyrtim apo të vendoset ndryshe.

Numri i lëndës: 2019:282960  
Datë: 04.09.2024  
Numri i dokumentit: 06122133

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 195 par. 1 pika (d) e LPK-së, të zbatueshëm sipas neni 63 të LKA -së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
Dhomat e Shkallës së Dytë  
K.DH.SH.II.nr.1069/22, me datë 28.08.2024

Kryetari i Kolegjit, gjyqtari  
Ramush Bardiqi